

PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES NË SHËRBIMIN CIVIL



Rruga: "Abdi Toptani",
ish-hotel "Drini", Tiranë
Tel: +355 4226 8141
info@kmshc.al; kmshc@kmshc.al
www.kmshc.al

Çfarë është përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil?

Instituti i përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil është mbarimi i statusit të nëpunësit civil për shkak të lirimit, largimit nga shërbimi civil si pasojë e procedimit disiplinor, dorëheqjes, arritjes së moshës së pensionit, vdekjes së nëpunësit civil, pavlefshmërisë së aktit të emërimit, humbjes së zotësisë për të vepruar apo shtetësisë shqiptare dhe dënimit për vepër penale me vendim të formës së prerë.

Ku dorëzohet dorëheqja dhe forma e paraqitjes së saj?

Nëpunësi civil njofton përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes me shkrim te njësia e burimeve njerëzore.

Kur i krijon efektet dorëheqja?

Dorëheqja i krijon efektet 30 ditë nga data e paraqitjes së saj, por në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar të nëpunësit dhe me miratimin e njësisë së burimeve njerëzore dorëheqja mund t'i prodhojë efektet përpara afatit 30-ditor të njoftimit.

A ka të drejtë nëpunësi të konkurroj për lëvizje paralele apo ngritje në detyrë nëse jep dorëheqjen?

Nëpunësi civil që jep dorëheqjen ka të drejtë të konkurrojë për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë deri në 2 vjet pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil.